



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA RROGOZHINË  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3262 Prot.

Rrogozhinë, më 14.09.2023

## NJOFTIM

Në mbështetje të pikës 4, nenit 53 të Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Rrogozhinë”, njoftoj thirrjen e mbledhjes e radhës të Këshillit Bashkiak e cila **do të zhvillohet në sallën e mbledhjeve të Këshillit, ditën e Martë datë 19.09.2023 ora 15:00<sup>oo</sup>**, me rendin e ditës si më poshtë :

- 1- Miratim i rendit të ditës.
- 2- Miratim i procesverbalit Nr.5, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 06.09.2023.
- 3- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Gusht 2023 nga fondi i Blllok - Ndihmës 6%”.
- 4- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shtator 2023 nga fondi i pushtetit vendor”.
- 5- Miratim i projekt-vendimit, “Për fillimin e procesit zgjedhor për zgjedhjen e strukturave komunitare në fshat”.
- 6- Miratim i projekt-vendimit, “Për dhënie autorizimi kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë me objekt : Hartimin, nënshkrimin e marrëveshjes së posaçme ndërmjet bashkisë Rrogozhinë dhe Avokaturës së Shtetit për të autorizuar e legjitimuar Avokaturën e Shtetit për të nënshkruar, depozituar rekursin për ta përfaqësuar bashkinë Rrogozhinë në Gjykatën e Lartë të RSH”.
- 7- Miratim i projekt-vendimit, “Për pagimin e shpenzimeve të varrimit”.
- 8- Miratim i projekt-vendimit, “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit Bashkiak nr.77 datë 27.12.2023 ‘Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2023”.
- 9- Miratim i projekt-vendimit, “Për miratimin për servitut kalimi në pasurinë nr.1/187, zona kadastrale 3234, lagja nr.1, në Bashkinë Rrogozhinë” të kërkesës së z. Agron Aliu.
- 10- Shqyrtim i analizës së Realizimit të të ardhurave për 6-mujorin e parë 2023, ardhur nga drejtoria e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik.

-vijon-



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA RROGOZHINË  
KËSHILLI BASHKIAK

- 11- Shqyrtim i Informacionit mbi punën e bërë në drejtim të aplikimeve të lejeve online, projekteve të reja, procesin e legalizimeve dhe evidentimin e problemeve të kadastrës dhe pronave ardhur nga Drejtoria e Politikave Urbane pranë Bashkisë Rrogozhinë
- 12- Informacion nga Drejtori e Bujqësisë, mbi punën e bërë dhe masat që do të merren në sistemin e kullimit për periudhën Shtator 2023-Mars 2024.
- 13- Informacion mbi punën e bërë nga sektori i pyjeve dhe përmirësimin e shërbimeve dhe veprimtarisë që ofron në këtë fushë.
- 14- Shqyrtim i kërkesës së ardhur nga Këshilli Mbikqyrës i Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a për dhënie opinionimi mbi propozimin për aplikimin e tarifave të reja në Bashkinë Rrogozhinë.
- 15- Të ndryshme.

*-Për pikat 5 dhe 6 të rendit të ditës do të shqyrtohet i njëjti material i cili ju është në dispozicion në mbledhjen e kaluar datë 06.09.2023.*

**Mbledhjet e Komisioneve të KB**, si më poshtë :

- **Njoftoj të mblidhet ditën e Hënë datë 18.09.2023 ora 09 : 00<sup>oo</sup>, Komisioni i Financës, Taksave dhe Revizionimit**, me këtë përbërje : Alime Hoxha - Kryetare, Bajazit Thaçi - Zv. Kryetar, Enver Memolla - Anëtar, Gëzime Met-hasani - Anëtare, Indrit Dedej - Anëtar.
- **Njoftoj të mblidhet ditën e Hënë datë 18.09.2023 ora 09 : 30<sup>oo</sup> i Urbanistikës, Zhvillimit Ekonomik dhe Infrastrukturës**, me këtë përbërje : Shpati Kolgega - Kryetar, Saimir Cani - Zv. Kryetar, Renato Kalemi - Anëtar, Gezime Met-hasani - Anëtare, Lije Dedej - Anëtare.
- **Njoftoj të mblidhet ditën e Hënë datë 18.09.2023 ora 10 : 00<sup>oo</sup> Komisioni Juridike, Rend, Konflikte**, me këtë përbërje : Mitat Daja - Kryetar, Indrit Dedej - Zv. Kryetar, Lulzim Hasa - Anëtar, Renato Kalemi - Anëtar, Bajazit Thaçi - Anëtar.
- **Njoftoj të mblidhet ditën e Hënë datë 18.09.2023 ora 10 : 30<sup>oo</sup> Komisioni i Shërbimeve Publike, Bujqësi, Blegtori dhe Pronave**, me këtë përbërje : Lulzim Hasa - Kryetar, Ferdi Avdiu - Zv. Kryetar, Fatmira Thartori - Anëtare, Altin Tosku - Anëtar, Hekuran Xhani - Anëtar.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**KRYETARE E KËSHILLIT  
MUKADES GIXHARI**

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com